

AKT THEME LIMI DHE STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“Servis Sharka” SH.P.K

Sot me date 08/04/2024 :

- Çlirim Sharka, atesia Zylyf , shtetas Shqipetar lindur me 18/06/1988 ne Lushnje, banues ne Tirane, me dokument identifikimi me I80618065W;

Bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare» i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 , Ligjt nr. 9723, dt. 03.05.2007 ”Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, LIGJ Nr. 131/2015 PER QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil ne cilesine e ortakeve themelues si dhe ne vullnetin tone te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e akteve te themelimit te shoqerise kemi hartuar aktin e themelimit dhe statutin e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte shoqeria):

KREU I
THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA
NENI. 1
DATA E THEMELIMIT, EMRI I THEMELUESIT

Sot ne date 08/04/2024,u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin

“Servis Sharka”” SH.P.K

1. Themeluesit e shoqerise jane :

- Çlirim Sharka, atesia Zylyf , shtetas Shqipetar lindur me 18/06/1988 ne Lushnje, banues ne Tirane, me dokument identifikimi me I80618065W;
- NENI. 2
OBJEKTI I SHOQERISE

Objekt i kesaj shoqerie do te jete:

Autoservis dhe Makina me Qera, shitje blerje automjete te perdonura.

Cdo veprimtari tjetër që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të Shoqerisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi.

Per te gjitha aktivitetet që kerkojmë numri i marrës shoqeriei është univok i kujdesuar kurrësia e ligjeve te posacme.

NENI. 3
KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete deri ne nje afat te papercaktuar
Shoqeria mund te prishet perpara ketij afati me vendim te asamblese se Ortakeve.

NENI. 4
SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise .eshte ne adresen: Njësia Bashkiake Nr.8, Rruga "Ramazan Farka", Pallati Nr.1, Shkalla 1, Kati 1.

KREU II
KAPITALI
NENI. 5

KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqerise do te jete 100.000(njeqind mijë) leke i perbere nga nje kuote.

Pjesemarrja e ortakut themelues ne kapitalin e shoqerise eshte:

Kontributi ne kapitalin e shoqerise eshte 100.000 leke dhe perbehet nga 1 (nje) kuote me vlerë nominale 100.000 leke nga Ortaku :

- Çlirim Sharka, atesia Zylyf , shtetas Shqipetar lindur me 18/06/1988 ne Lushnje, banues ne Tirane, me dokument identifikimi me I80618065W; zoteron 100% te kuotes me vlerë 100.000 leke.

Kontributet e ortakeve mund te jene ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo te drejta).

NENI. 6
ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

NENI. 7
TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me perjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes

- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.

Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me rruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE
NENI. 8
ORGANET VENDIMMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

Asambleja e per gjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshjet si me poshte:

- a. Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b. Ndryshimet e statutit
- c. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d. Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e. Percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f. Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimitarise
- g. Miratimi i bilanceve
- h. Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- i. Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre
- j. Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k. Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l. Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqsues i ortakeve ne asamblene e per gjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9

THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PER GJITHSHME

Asambleja e per gjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e per gjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij nenii, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullslse.



NENI 10
KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e per gjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e per gjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregetaret dhe Shoqerite tregetare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi i permendur ne paragrafin e mesiperm nuk arrihet, asambleja e per gjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11
MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e per gjithshme vodos me $\frac{3}{4}$ e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizmin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e per gjithshme vodos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.

Cdo ndryshim duhet te depozitet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12
PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e per gjithshme merr vendimin pet:

- a) vleresmin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padje ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaquesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konfikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13
ADMINISTRIMI

Asambleja e per gjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte riperteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Personi i me poshtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise, duke patur te drejta te pakufizuaru administrimi.

- Çlirim Sharka, atesia Zylyf , shtetas Shqipetar lindur me 18/06/1988 ne Lushnje, banues ne Tirane, me dokument identifikimi me I80618065W;

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratorret kane te drejte dhe detyrohen te:

- Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e per gjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- Perfaqesojne shoqerine
- Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- PergatIsIn dhe nenshkruajne bilancIn vjetor, bilancIn e konsoliduar dhe raportIn e ecurIse se veprImtarIse dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratIm
- Krijojne një sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise
- Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e per gjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

NENI 15

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

- Administratori eshte per gjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate admInIstrImIt te shoqerise. Administratoret te cilet kane kryer veprImet ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane per gjegjes per demet e sjella shoqerise dhe per gjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.
- Nese administratori vpron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

KREU IV

VITI FINANCIAR -EKSPERTET

NENI 16

VITI FINANCIAR

Viti finaciar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, Perjashtimisht , viti i pare finaciar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllte me 31 dhjetor.

NENI 17
EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit finanziar vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara.

KREU 5
PRISHJA DHE RI-ORGANIZIMI I SHOQUERISE

NENI 18
PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQUERISE

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b. Me vendimet e asamblese se Ortakeve
- c. Me hapjen e procedurave te falimentit
- d. Nese nuk zhvillon aktivitet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare te Regjistrimit,
- e. Me vendim **gjkate**.

NENI 19
RIORGANIZIMI I SHOQUERISE

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjt mbi shoqerite tregtare.


ART. 20
KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Ortaket dhe administratoret e shoqerise me perjegjesi te kufizuar, nuk mund te mbajne pozicionin drejtues apo te jene te punesuar ne nje shoqeri qe ushtron aktivitet ne te njeften fushe me te paren. Ndalimi i pikes 1 mund te anulohet ne asamblene e pare te pergjithshme me $\frac{3}{4}$ e votave ne sipas dispozitave te neneve 87 dhe 145 te ligjt per shoqerite tregtare.

NENI 21
LEGJISLACIONI

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 22
MOSMARREVESHJET



Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kompetente per zgjdhjen e tyre do te jete Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u redaktua ne 2 kopje ne gjuhen shqipe, me vlore te njezte ligjore.

ORTAKET THEMELUES

Gjinim Shorpa

